

Një dritare në diversitetin bimor të Europës

Prill 2009

Takimet Kombëtare dhe marrëveshjet Ndërkombëtare

Në 2001, Nevoja për një sistem informacioni Europian mbi resurset gjenetike bimore u realizua në vitin 2001, me krijimin e inventareve kombëtare të resurseve gjenetike bimore dhe të katalogut EURISCO, një katalog kërkues i koleksioneve bimore *ex situ* të ruajtura në Europë. Një sistem i tillë ishte një domosdoshmëri nga Traktatet Ndërkombëtare mbi Resurset Gjenetike të Bimëve për Ushqimin dhe Bujqësinë si dhe në Planin Global të Veprimit për Konservimin dhe mbështetjen e Përdorimit të Resurseve Gjenetike të Bimëve për Ushqimin dhe Bujqësinë.

Gjithashtu EURISCO përfshin detyrimet e Konventës mbi Diversitetin Biologjik për lehtësimin e shkëmbimit të informacionit mbi konservimin dhe mbështetjen e përdorimit të diversitetit biologjik dhe kontribuon në Strategjinë e Diversitetit Biologjik Europian.

Katalogu EURISCO doli për herë të parë në Shtator 2003.

Çfarë është katalogu EURISCO?

EURISCO është një katalog i bazuar në faqen Web që siguron informacion mbi koleksionet bimore *ex situ* në mbarë Europën. Ai aktualisht përmban të dhënat e pasaportës për më tepër se 1 133 695 mostra të diversitetit të bimëve të arave që përfshijnë 1400 gjini dhe 8750 specie nga 38 vende. Këto mostra të diversitetit të bimëve të



Kërkesa e sotme për më tepër produkte ushqimore të ndryshme, forcon përdorimin e një variacioni më të gjërë të diversitetit gjenetik bimor.

arave paraqesin më shumë se gjysmën e aksesioneve të ruajtura në Europë dhe afërsisht 19% të totalit botëror.

I ngritur sipas standarteve ndërkombëtare, EURISCO është si “një magazine” për informim mbi koleksionet bimore *ex situ*; ai ju bën të mundur përdoruesëve të kërkojnë dhe gjejnë informacion mbi bimët e arave, foragjeret, speciet barishtore dhe të egra, varietetet e fermerëve dhe linjat e seleksionuara; EURISCO mundëson realizimin e kërkimit në bazë të bimës, taksonomisë, origjinës, gjeografisë, datës së pranimit, statusit të mostrës dhe kritereve të tjera.

Funksionimi dhe kush mer pjesë

Nëpërmjet forcimit të kapaciteteve për krijimin e inventareve kombëtare, EURISCO krijon një pikë hyrje të shpejtë nga ku ato mund të kërkohen. Çdo vend ka përgjegjësi të plotë dhe të drejta sovraane për të vendosur mbi vënien në përdorim, korrektësinë (në të gjitha detajet), sigurinë dhe transferimin e të dhënave të inventareve të tyre kombëtare. Meqenëse personat kombëtarë të kontaktit në EURISCO transferojnë gradualisht inventaret e tyre kombëtare të resurseve gjenetike bimore, katalogu EURISCO është duke u zgjeruar dhe përmirësuar.

*Aksesione e Bankave Gjenetike
përfaqësojnë repositorët aktualë
dhe potencialë të materialit gjenetik
të dobishëm për seleksionerët,
kërkuesit dhe trainuesit, e për rrjedhim
mbështesin sigurinë ushqimore.*



Çfarë bën EURISCO?

EURISCO lejon akses në informacion që shërben jo vetëm për vendim-marësit por gjithashtu dhe për menaxherët e bankave gjenetike, kuratorët, shkencëtarët, seleksionerët, fermerët, studentët dhe për publikun e gjërë duke ju përgjigjur kërkesave mbi informacionin për resurset e ruajtura *ex situ* në vendet e Europës.

Duke vështruar për të ardhmen

Në fazën e dytë, EURISCO do të fokusohet në sigurimin e mbështetjes ndaj inventareve kombëtare dhe të personave të kontaktit të tyre, do vazhdojë të përmirësojë saktësinë dhe shkallën e informacionit të vlefshëm si dhe pasurimin e funksionaliteteve. Gjithashtu do të tentohet ngritja e një Sistemi Informimi European që do të sjellë informacionin *ex situ*, bashkë me atë *in situ*, në një pikë hyrëse globale e cila lidhet me burime të tjera informacioni nëpërmjet serviseve Web.

E ardhmja po ndërtohet duke siguruar akses në informacion si një pasuri publike dhe duke rritur ndërgjegjësimin e brezave të ardhshëm mbi resurset gjenetike bimore.

Inisiativa për të filluar aktivitete të ngjashme në rajone të tjera janë tashmë në vazhdim e sipër.



*Njohuritë tradicionale dhe diversiteti
kulturor, mbështesin përdorimin
e diversitetit bimor në rrugë
të ndryshme e për qëllime
të ndryshme.*

